

Financuar  
nga Bashkimi Evropian  
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet  
nga Këshilli i Evropës



INFORMOHU  
PËR NDIHMËN  
JURIDIKE FALAS

**PYETJE QË SHTROHEN SHPESH NË LIDHJE ME  
MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

## ÇFARË ËSHTË DISKRIMINIMI?

Diskriminimi është **kurbëhet çfarëdo dallimi, përjashtimi, kufizimi apo dhënie e përparësisë që bazohet në bazë diskriminuese**, me veprim apo mosveprim, që ka për qëllim apo rrjedhje parandalimin, kufizimin, njohjen, të gëzuarit apo realizimin e lirive dhe të drejtave të personit apo grupit të caktuar në bazë të barabartë me të tjerët.

Kjo përfshin të gjithë format e diskriminimit, duke përfshirë edhe pamundësimin e përshtatjes përkatëse dhe pamundësimin e qasshmërisë dhe disponueshmërisë të infrastrukturës, të mirave dhe shërbimeve.

## SI TA DIJË QË JAM DISKRIMINUAR?

Nëse e ndjen se merr trajtim të ndryshëm nga të tjerët për shkak të ngjyrës tënde të lëkurës, përkatësisë nacionale, gjinisë, seksit, religjionit... **dhe, ke të drejtë të dyshosh se po përjeton diskriminim.**

Nëse nuk mund ta pohosh me siguri, apo dëshiron të marrësh më shumë informacione, të inkurajojmë që të drejtohesh te dhënësit e ndihmës juridike falas dhe organizatat civile të cilat punojnë në mbrojtjen nga diskriminimi.

## ÇFARË NËSE DISKRIMINOHEM PËR NDOJË BAZË QË NUK ËSHTË PËRMENDUR NË LIGJ?

Në këtë moment, ligji jonë si baza të diskriminimit i përmend: diskriminimin në bazë të racës, ngjyrës të lëkurës, preardhjes nacionale apo përkatësisë etnike, gjinisë, seksit, orientimit seksual, identitetit gjinor, përkatësisë të grupit të marginalizuar, gjuhës, shtetësisë, prejardhjes sociale, arsimit, religjionit apo besimit fetar, bindjes politike, aftësisë të kufizuar, moshës, gjendjes familjare apo martesore, statusit pronësor, gjendjes shëndetësore, cilësisë personale dhe statusit personal apo çfarëdo bazë tjetër.

Nëse baza në të cilën ti përjeton diskriminim nuk është përfshirë me përkufizim, mbrojtjen nga diskriminimi e kërkon sipas fjalëve të fundit të përkufizimi- “cilado bazë tjetër”. Kjo është e mjaftueshme për Komisionin për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi që të shqyrtojë rastin tënd.

### KU MUND TË PARAQES DISKRIMINIM?



[www.pravnapomos.mk](http://www.pravnapomos.mk)



Mund të parashtrosh parashtresë deri te **Komisioni për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi**, që është një trup i veçantë i formuar për mbrojtje nga diskriminimi dhe avancimi i barazisë, të drejtat e njeriut dhe mosdiskriminimi.





## A DUHET TA DËSHMOJË SE JAM DUKE PËRJETUAR DISKRIMINIM?

**Jo.** Prej teje kërkohet vetëm **që të japësh informata dhe dëshmi se me të vërtetë veprimi në të cilin ke përjetuar diskriminimin ka ndodhur.**

Nëse jepni të dhëna të tilla të mjaftueshme, Komisioni nuk do të kërkojë nga ty që ta dëshmosh diskriminimin, po do të ftojë personin (apo personat) për të cilët pohon se ka diskriminuar, të dëshmojë tezën e tij.

## A MUND TË MË NDIHMOJË DIKUSH QË TË PARAQES DISKRIMINIMIN?

Shoqatat e regjistruara për ndihmë juridike falas kanë autorizime që t'ju ndihmojë gjatë përgatitjes të parashtrësës deri te Komisioni. Kontaktet e këtyre shoqatave do i gjeni në

<https://www.pravda.gov.mk/bpp>

## A DUHET TË PREZANTOHEM PERSONALISHT QË TË PARAQES DISKRIMINIMIN?

Nëse diskriminimi të cilin e përjeton është problem për të gjithë grupin të cilit i takon, dhe nuk është e lidhur me ty personalisht, atëherë në vend tënd procedurën mund ta ndërmarrin organizatat civile të cilat kanë interes të arsyetuar për mbrojtje të interesave të grupit të caktuar apo në kuadër të veprimtarisë të tyre merren me mbrojtjen nga diskriminimi.

Atëherë procedura do të inicohet në emër të tyre, kurse emri i juaj do të mbesë i mbrojtur.

## A ËSHTË E SHTRËNJTË PROCEDURA PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI?

**Procedura para Komisionit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi është falas.**

Në procedurën gjyqësore, personi që do të iniciojë kontest për mbrojtje nga diskriminimi është liruar nga taksat gjyqësore. Personi nuk është i liruar nga shpenzimet e avokatit në rast se e humb kontestin.



## KU MUND TË DREJTOHEM PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS?

- ✓ Shoqata dhe klinika juridike të cilat janë të autorizuar për dhënien e ndihmës juridike falas
- ✓ Avokatë me kompetenca të fituara për dhënien e ndihmës juridike dytësore
- ✓ Në zyrat rajonale të Ministria e Drejtësisë (lista e kontakteve në shtojcë):

Njësitë rajonale	Telefonat
Berovë	071 205 324
Manastir	071 223 392
Makedonski Brod	071 223 075; 078 640 786
Vinicë	071 213 964
Vallandovë	071 213 925
Gjevgjeli	071 224 678; 071 216 267
Gostivar	071 223 180
Dibër	071 223 768
Delçevë	071 283 948
Demir Hisa	075 766 695
Kavadarë	075 659 855
Kërçovë	071 224 652
Koçanë	071 221 580
Kratovë	
Kriva Pallankë	071 224 580
Krushevë	071 227 808
Kumanovë	071 227 962

Njësitë rajonale	Telefonat
Negotinë	071 223 191
Ohër	071 221 908
Prilep	076 232 886
Probishtip	078 330 434
Radovish	070 261 310
Resnjë	071 221 246
Sveti Nikole	071 227 862
Strugë	071 223 015
Strumicë	071 224 526
Tetovë	071 227 893
Veles	
Shtip	071 221 484; 070 821 089
Karposh	071221381
Qendra	078 442 006
Kisella Vodë	071 224 104
Gazi Babë	071 213 798
Çairit	

Pyetje që shtrohen shpesh në lidhje me mbrojtjen nga diskriminimi





INFORMOHU  
PËR NDIHMËN  
JURIDIKE FALAS

[www.pravnapomos.mk](http://www.pravnapomos.mk)

Ky dokument u prodhuan me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës.  
Qëndrimet e shprehura në të nuk shprehin domosdoshmërisht mendimin zyrtar të secilës palë.

Financuar  
nga Bashkimi Evropian  
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet  
nga Këshilli i Evropës



Republika e Maqedonisë së Veriut

Ministria e Drejtësisë